




REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/01-54874 dt. 13/11/ 2024

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Bekim Lestrani, me dt. **20.11.2024** (e mërkurë) duke filluar në ora 10:00, në sallën e mbledhjeve të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 18.10.2024.
2. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare subvencione dhe transfere me nr. 02-400/01-47954 dt. 30.09.2024.
3. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt.19.09.2024.
4. Të ndryshme.

Drenas, 13.11.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani
Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-54791 dt. 13/11/2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më **18.10.2024**, e cilia filloj ne ora **10:00**.

Mbledhjen e kryesoi: Bekim Lestrani - kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, ku të pranishëm ishin: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunes, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe drejtor të drejtorive komunale.

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 20.09.2024;
2. Propozim-vendimi për caktimin e anëtarëve të Komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit;
3. Draft Propozim Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2025-2029;
4. Raporti financiar janar- shtator 2024;
5. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023;
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha së unë i kam disa kërkesa të kompanive të ndryshme të cilat në muaji të ndryshëm kanë kërkuar me marrë pronën në shfrytëzim përmes negocimit unë i kam një, dy, tri, prona që i kanë kërkuar është një në muajin e pestë një në muajin e shtatë etj.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha së me propozimin që bëri Kryetari të pikat e ndryshme hedhim në votim këtë rend ditë dhe ky rend ditë rekomandohet për Kuvend në mënyrë unanime. Hapi për diskutim pikën 1: Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.09.2024.

Pasi nuk pati diskutim në pikën e parë të rendit të dites, u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 2: Propozim-vendimin për caktimin e anëtarëve të Komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit.

Arbër Halilaj, tha së, është çështje me shumë teknike, ndoshta është të Arbësa Dobra, kisha dashtë të ceket se, është në bazë të udhëzimit të MASHT-it, që të ceket këtu së është kryesuese e komisionit, sepse Arben Haziri sigurisht këshilli prinderve ka pasur takim që është përzgjedhur. Pasi është edhe Kryetari këtu si pyetje të përbërja e komisionit, në aspektin e udhëzimit jemi në rregull, kryesuesja edhe Arbeni d.m.th kanë nivel të kualifikimit vëtem deshta të ceki që Arbësa me automatizem është kryesuese e komisionit.

Hamit Haxhiu, d.m.th ne jemi në rregull në bazë të asaj që lexove dhe diskutove në bazë të asaj që kërkohet me udhëzim administrativ.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, rekomandon për Kuvend pikën 2: Propozim-vendimin për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për drejtor në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Drenasit. Kjo pikë rekomandohet për Kuvend në mënyrë unanime. Hapi për diskutim pikën 3: të rendit të dites. Draft Propozim Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2025-2029.

Arbër Halilaj, unë jam që kjo të debatohet në sancen e Kuvendit, ndërsa ndonjë sygjërim eventual sa I përket strategjisë do të dërgoi në email.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, deri me dt. 22 është në debat, mundeni me e dërguar edhe nëse e shohin edhe kompania edhe komisioni, gjithsesi çdo mendim, ide i mirë është mirë me hy, sepse kjo është Draft strategjia e zhvillimit ekonomik.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, rekomandon për Kuvend pikën 3: Draft Propozim Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2025-2029, kjo pike rekomandohet për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ju e dini që ky raport është dashtë me shkuar në korrik ose gusht në Kuvend, por për shkak se Kuvendi nuk ka qenë aktiv tash që shkon është raport nëntë mujor janar - shtator.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 4: Raporti financiar janar - shtator 2024, diskutime nuk pati dhe kjo pikë rekomandohet për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha se a e dini që ky raport është dashur me shkuar në korrik ose gusht në Kuvend, por për shkak së Kuvendi nuk ka qenë aktiv, Kuvendi tash që shkon është raport nëntë mujor janar –shtator.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, rekomandon për Kuvend pikën 4: Raporti Financiar janar - shtator 2024, diskutime nuk pati edhe kjo pikë rekomandohet për Kuvend në

mënyrë unanime. Hapi për diskutim 5. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha së a e dini që raporti i auditorit shkon për debat në Kuvend sigurisht që është dashtë me shkuar në muajt e kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, rekomandon për Kuvend pikën 5. Raporti i Auditimit për pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023. Në mënyrë unanime.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, tha së të pikat e ndryshme do t'i sjellim kërkesa të gjithë atyre që kanë interes për me marr prona në shfrytëzim nga Komuna dhe Kuvendi. Le të vendos së si të procedojnë, në qoftë së e vlerësojnë së mundë të negociohet me ndonjë pronë, ne bëjmë një komision prap nga Kuvendi që do të na rekomandoj neve zhvillimin e negociatave me kompanitë dhe do të organizojmë edhe dëgjimet buxhetore.


Ne i kemi prodhuar edhe katër dokumente në punëtorin e Brezovicës, që i kemi mbajte me zyrtar e drejtorë.

Kamer Rama, lista e rreziqeve ka afat deri në përfundim të këtij viti ndërsa për planin e integritetit nuk mundem me thënë asgjë, sepse ka ndryshuar legjislacioni dhe është absurde me raportuar për vitin para së me përfunduar viti. Ndërsa raportin e progresit është dashtë me e dërguar me 30 shtator, ne jemi vonuar pak, po në këtë mbledhje duhet të qesim patjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, tha së pasi nuk pati diskutime të tjera e konsiderojmë të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj rreth orës 10:30.


Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-54712 dt. 13/11/2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 34 dhe 34.6 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit për transfer të mjeteve financiare subvencione dhe transfere me Nr.02-400/01-47954 dt. 30.09.2024

Neni 1


Më këtë Propozim Vendim i propozohet Kuvendit të Komunës shfuqizimi i vendimit Nr.02-400/01-47954 të datës 30/09/2024, për transfer të mjeteve financiare të kategoris ekonomike Subvencione dhe Transfere në shumën pre 6,825.00 euro.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit Nr.02-400/01-47954 të datës 30/09/2024, bëhet për arsye të mungesës së mjeteve të cilat janë terhequr për kontrata kolektive parase të kthehet ligjshmeria:

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

I'u dërgohet:

- *Zyrës së kryetarit*
- *Zyrës së kuvendit*
- *DBZHR-së*
- *DBF-së*
- *Arkivit*



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-400/01-54875 Dt. 13/11/2024

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit nxjerr:

PROPOZIM – VENDIM

**Për shfuqizimin e vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220
dt.19.09.2024**

Neni 1

Më këtë propozim-vendim, i propozohet kuvendit të komunës shfuqizimi i vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt.19.09.2024

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit për ndryshimin e emrit të projektit me nr. 02-400/01-46220 dt.19.09.2024 behet me rekomandim të Ministrisë, pasi që nuk ka kaluar ligjshmerinë.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlersimit të ligjshmerisë nga MAPL.

KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

